



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Naim Shuki BI" të datës 02.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.11.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së ritender" me nr. të prokurimit 616-24-10217-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Naim Shuki BI" të datës 02.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.11.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së ritender" me nr. të prokurimit 616-24-10217-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Naim Shuki BI" (tutje "parashtruesi") me datë 02.12.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 25.11.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-së ritender" me nr. të prokurimit 616-24-10217-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Pretendimi AK që për mostrat nuk ka baze ligjore dhe Mostrat e OE Naim Shuki BI plotson të gjitha kërkesat e AK-s sipas kërkesës që ka bërë në eprokurim për hapjes së ofertave, AK me datë 07.10.2024 dhe në eprokurim është ngarkuar dosje dhe përshkrimi më i mirë korrigjuar për artikuj dimrorer dhe në asnjë pozicion nuk figuron standardet ISO për Shiritat, ngjyra e astarit, pjesa brendshme e xhakës dhe duhet të zingjir apo të ngarkuar në eprokurim dhe nuk ka baze ligjore për të eliminuar OE Naim Shuki BI. AK në Aneksin 1 TD Specifikimet teknikë të detyrueshme nuk ka kurrfarë specifikacion për kërkesat lartshenuar e cili është bërë anulimi i procedurës në të OE Naim Shuki BI pasi që jemi vetë prodhues kemi mundësi të plotsojmë të gjitha kërkesat lartshenuar nëse është kërkuar këto për hapjes së oferte".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i përgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Operatori Ekonomik; Naim Shuki B.I, tek mostrat e ofruara nuk i plotëson kriteret si në vijim; Xhaketa me 2 shirita reflektues sipas standardit UNI EN ISO 20471:2017, Astar i brendshëm i xhakës nga rrjeta 100%, Ngjyra jo e kuqe, Nuk hiqet me zinxhirë pjesa e brendshme, tek pantallonat xhepat nuk kanë mbyllje me zinxhirë, Duksi po ashtu ngjyra nuk është në baze të specifikave dhe një xhep me zinxhirë në anën e lartë, si dhe Këpucët dimërore nuk janë në harmoni me specifikat kurse të gjitha të tjera jo, ndërkaq mostrat të cilat I ka ofruar OE;

Sa i përket pretendimit se arsye të eliminueshme nuk janë të përcaktuara me specifika teknike, ky pretendim nuk qëndron pasi që secila nga arsye të eliminueshme derivon në mënyrë konkrete nga specifikat teknikë të detyrueshme. Si shembull kërkesa që xhaketa me 2 shirita reflektues duhet të jetë sipas UNI EN ISO 20471:2017 është në faqe 2 të ST ku thuhet se "Xhaketa duhet të ketë dy shirita reflektues sipas standardit UNI EN ISO 20471:2017". Tjetër kërkesa që astari i brendshëm të jetë 100% nga rrjeta është po ashtu në fq. 2 të ST ku thuhet se "Astar i brendshëm i xhakës duhet të jetë nga rrjeta 100% poliamide me peshë $120\text{g/m}^2 \pm 5\%$ ". Po ashtu në fq. 2 është edhe kërkesa për ngjyrë të kuqe ku thuhet "Ngjyra: E kuqe", etj. Pra të gjitha arsye të eliminueshme derivojnë nga ST prandaj kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar. Sa i përket pretendimit se specifikat teknikë janë ngarkuar në eprokurim pas anulimit të aktivitetit, ky pretendim po ashtu nuk qëndron pasi që specifikat teknikë janë pjesë e dosjes së tenderit. Në fakt nuk mund të iniciohet fare aktiviteti i prokurimit pa ST. Mirëpo për shkak të vëllimit të madh nuk janë ngarkuar në eprokurim në kuadër të DT është AK është detyruar që të njëjtën t'a ngarkoj ndaras. Përndryshe të gjithë OE të interesuar kanë pasur mundësi që para hapjes së ofertave të kërkojnë qasje në ST. Sidoqoftë aktiviteti i prokurimit si i tillë është anuluar dhe në mundësinë e parë dhe sipas interesit të njësisë kërkuese do të ritenderohet ndërsa të gjithë OE të interesuar mund të dorëzojnë sërish ofertën e tyre në përputhje me të gjitha specifikat teknikë të detyrueshme.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.12.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.